

Κοινοποιείται από τον αρμόδιο αστυνομικό στον υπό απέλαση κρατούμενο αλλοδαπό, με αποδεικτικό.	Υπόδειγμα: ΚΑ-141 η (1)
Υπόδειγμα: Πληροφοριακό δελτίο για τους υπό απέλαση κρατούμενους αλλοδαπούς.	ΑΛΒΑΝΙΚΑ

REPUBLIKA GREKE
POLICIA GREKE

Τίτλος Υπηρεσίας (emri i shërbimit)

BULETIN INFORMATIV

(Për të burgosurit e huaj për ekstradim)

1. Siç jeni informuar, qëndrimi juaj në shtetin tonë nuk është i ligjshëm. Qëndrimi i ligjshëm i shtetasit të huaj përcaktohet nga hyrja e ligjshme në territorin grek, me dokument të vlefshëm udhëtimi, ose me leje të vlefshme qëndrimi të lëshuar nga autoriteti kompetent grek dhe përderisa nuk ekzistojnë arsye të ligjshme për heqjen e së drejtës së qëndrimit. (L.3386/2005 Gazeta Zyrtare Vëll. A'-212).
2. Aktualisht mbaheni konform ligjit provizorisht në qendrën tonë policore deri sa të përfundojnë formalitetet e ekstradimit tuaj. Duhet të silleni qetë dhe të dorëzoni pasaportën tuaj ose dokument tjetër udhëtimi ose çdo dokument tjetër identiteti që ju kërkohet.
3. Kompetent për çështjen tuaj është
βαθμός – ονοματεπώνυμο Αστυνομικού (emri dhe mbiemri i punonjësit të policisë) i cili ka për detyrë t'ju shpjegojë të drejtat tuaja. Për ankesat tuaja eventuale mund t'i drejtoheni shefit të autoritetit policor.
4. Gjatë kohës së mbajtjes suaj keni të drejtë:
 - a. Të pajtoni me shpenzimet tuaja avokat të preferencës suaj. Autoriteti policor do t'ju shërbejë që ai t'ju vizitojë dhe të këshilloheni me të.
 - b. Të kërkoni që të informohet Autoriteti Konsullor i shtetit tuaj në Greqi. T'ju vizitojnë përfaqësuesit e tij dhe të komunikoni me ta.
 - c. T'ju vizitojnë personat tuaj të afërm. Hollësitat për kohën dhe shpeshtësinë e vizitave janë në dispozicionin tuaj.

⇒-----

ΑΠΟΔΕΙΚΤΙΚΟ ΚΟΙΝΟΠΟΙΗΣΗΣ

(DËFTESË KOMUNIKIMI)

Παρέλαβα το πληροφοριακό δελτίο για τους υπό απέλαση κρατούμενους αλλοδαπούς και μου εξηγήθηκαν τα δικαιώματά μου. Mora në dorëzim buletinin informativ për të burgosurit e huaj për ekstradim dhe m'u shpjeguan të drejtat e mia. Υπογράφεται ως ακολούθως (Nënëshkruhet si vijon)

Ημερομηνία (Data) :/...../20...../Ωρα (ora).....

Ο Αστυνομικός (Punonjësi i policisë)

Ο/Η κρατούμενος/η (I/E burgosuri/a)

.....

.....

.....

Υπογραφή – Ονοματεπώνυμο -Υπηρεσία

Υπογραφή – Ονοματεπώνυμο - Υπηρεσία

(emri/mbiemri–firma–shtetësia)

d. Të paraqisni kundërshtimet tuaja ndaj nxjerrjes së vendimit të ekstradimit, brënda një afati të paktën prej 48 orësh nga data e dorëzimit të kësaj dëftese. Kundërshtimet mund t'i paraqisni punonjësit kopetent që trajton çështjen tuaj. Ky afat fillon në orën 00:00 të ditës së nesërme nga dorëzimi i kësaj dëftese dhe përfundon në orën 24:00 të ditës së punës së nesërme.

e. Të ushtroni rekurs ndaj vendimit të ekstradimit, brënda një afati prej 5 ditësh nga data e komunikimit tek ju, në Ministrinë e Brendshme ose në organin e autorizuar prej saj.* Ky afat fillon nga ora 00:00 e ditës së nesërme nga dorëzimi i vendimit të ekstradimit dhe përfundon në orën 24:00 të ditës së pestë pasuese. Vendimi përkatës shpallet brënda 3 ditëve pune nga ushtrimi i rekursit, i cili lidhet me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të ekstradimit dhe jo dhe me mbajtjen tuaj.

f. Të paraqisni kundërshtimet tuaja kundër vendimit të ndalimit tuaj te Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

g. Të deklaroni verbalisht ose me shkrim se kërkonti mbrojtje ndërkombëtare (strehim ose mbrojtje ndihmëse) ose të çdo forme, për të mos u ekstraduar në ndonjë shtet me rrezik persekutimi për shkaqe racore, fetare, etnike, klase shoqërore, ose bindje politike, sipas Konventës së Gjenevës të vitit 1951 ose me rrezik për dëmtime të rënda (dënim me vdekje ose ekzekutim, ose totrura, trajtim çnjerëzor ose poshtërues etj.)

5. Gjithashtu keni të drejtë:

a. Të kërkonti vizitë mjekësore në rast se keni probleme shëndetësore nga mjeku i preferencës suaj, me shpenzimet tuaja. Autoriteti Policor kujdeset për dhënien e ndihmës mjekësore nëpërmjet institucionit shëndetësor shtetëror. Në rast sëmundjeje serioze, aksidenti të rëndë ose shtrimi tuaj në çfarëdo institucion shëndetësor, lajmërohen personat tuaj të afërm të preferencës suaj në shtetin tonë si dhe Autoriteti Konsullor.

b. Të kërkonti me shpenzimet tuaja furnizimin me ushqime të posaçme. Autoriteti i Policisë do t'ju krijojë lehtësira që të shërbeheni sa të jetë e mundur më mirë.

6. Shpenzimet e ekstradimit ju rëndojnë tërësisht ose pjesërisht juve, në vartësi të shumës së parave që dispononi.

7. Shpresojmë në bashkëpunimin tuaj për të përfunduar sa më shpejt dhe mirë procesin e ekstradimit.

8. Sqarime të mëtejshme në lidhje me të drejtat tuaja mund t'i kërkonti punonjësit që është kopetent për çështjen tuaj.

⇒-----

** Γνωστοποιήθηκε στ πρόσθεν αναγραφόμεν.... κρατούμεν.... ότι προσήχθη στ.....
(τίτλος Αστυνομικής Υπηρεσίας)

και η ιδιότητα και το ονοματεπώνυμο του υπογράφοντος.

Ημερομηνία...../...../20..... ώρα.....

Ο Αστυνομικός

(Υπογραφή - βαθμός - ονοματεπώνυμο Αστυνομικού)

* Η αρμοδιότητα αυτή με την υπ' αριθμ. 7004/3/47 από 27-11-2007 (Φ.Ε.Κ. 2266/27-11-2007, Τεύχος Β') απόφαση του Υπουργού και Υφυπουργού Εσωτερικών μετεβίβασθηκε στους Γενικούς Αστυνομικούς Διευθυντές Περιφέρειας και στους Διευθυντές Διευθύνσεων Αλλοδαπών Αττικής και Θεσσαλονίκης.

* * Συμπληρώνεται μόνο σε περίπτωση προσαγωγής του κρατούμενου από την Υπηρεσία που κρατήθηκε αρχικά σε άλλη Αστυνομική Υπηρεσία.
- Συντάχθηκε από τη Διεύθυνση Αλλοδαπών του Αρχηγείου Ελληνικής Αστυνομίας.